



Besimi në Maqedoni

Besimi i përgjithshëm dhe besimi në institucionet
Besimi në shoqërinë civile
Njohja dhe mendimet për organizatat qytetare

Sasho Klekovski, Emina Nuredinoska, Daniella Stojanova

2010

Botues

Qendra Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar

Për botuesin

Sasho Klekovski, Drejtor i parë ekzekutiv

Autorë

Sasho Klekovski - I. Besimi i përgjithshëm dhe besimi në institucionet
Emina Nuredinoska - II. Besimi në shoqërinë civile
Daniella Stojanova - III. Njohja dhe mendimet për organizatat qytetare

Përgatitja

Daniella Stojanova

Shkup, dhjetor 2010

ISBN 978-608-4617-09-9

Mendimet që janë shprehur këtu u takojnë autorëve dhe nuk i reflektojnë qëndrimet e Qendrës Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar.

Qendra Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar

Të gjitha të drejtat janë ruajtur, riprodhimi, kopjimi, transmetimi ose përkthimi i cilës do qoftë pjese të këtij publikimi mund të bëhet vetëm nën kushtet që vijojnë: me leje parapake të botuesit, për shkak të citimit në analizë të librit dhe nën kushtet e cekura në vazhdim.

Të drejtat e autorit të këtij publikimi janë mbrojtur, por publikimi mund të riprodhohet në cilën do qoftë mënyrë dhe pa pagesë për qëllime edukative. Për kopjimin nën kushte tjera, për përdorim në publikime tjera ose për përkthim ose përshtatje, duhet të sigurohet leja paraprake nga botuesi.

PËRMBAJTJA

LISTA E SHKURTESAVE.....	4
PARATHËNIE.....	5
INDEKSET.....	6
HYRJE.....	8
Termet dhe definicionet.....	8
Metodologjia dhe qasja.....	8
I. BESIMI PËRGJITHSHËM DHE BESIMI NË INSTITUCIONET.....	10
Hyrje.....	10
Besimi i përgjithshëm.....	10
Besimi në institucionet.....	10
Besimi në sektorin shtetëror.....	12
Besimi në bashkësinë ndërkombëtare.....	14
Besimi në sektorin afarist.....	14
Besimi në profesione.....	14
Besimi dhe ndikimet socio-demografike.....	15
Përfundime.....	16
II. BESIMI NË SHOQËRINË CIVILE.....	18
Hyrje.....	18
Besimi në aktorët e shoqërisë civile.....	18
Qëndrime për organizatat qytetare.....	19
Besimi në organizatat qytetare sipas nën sektorëve të veprimit.....	21
Përfundime.....	22
III. NJOHJA DHE MENDIM PËR ORGANIZATAT QYTETARE.....	23
Hyrje.....	23
Njohja e organizatave qytetare.....	23
Njohja dhe qëndrime për njëzet e pesë organizata qytetare.....	26
Përfundime.....	28
Shtojca 1. Besimi dhe ndikimi i përkatësisë etnike dhe të simpativë ndaj partive politike.....	29
Shtojca 2. Pyetësor.....	31
Shtojca 3. Ekzemplari.....	34

LISTA E SHKURTESAVE

- ADI: Asociacioni për Iniciativa Demokratike
BDI: Bashkimi Demokratik për Integrim
BE: Bashkimi Evropian
BIM: Bashkësia Islame e Maqedonisë
BNJVL: Bashkësia e Njësive të Vetëqeverisjes Lokale
CIRA: Qendra për Zhvillim Institucional
DEM: Lëvizja e Ekologjistëve të Maqedonisë
ESE: Shoqata për Barazi, Solidaritet dhe Emancipim
FFRM: Federata e Fermerëve të Republikës së Maqedonisë
FISHHM: Fondacioni Instituti Shoqëria e Hapur - Maqedoni
IHSJP: Instituti për Hulumtime Sociologjike dhe Juridike-Politike
KB: Kombet e Bashkuara
KHDNJ: Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në Republikën e Maqedonisë
KNOIM: Këshilli Nacional i Organizatave Invalidore të Maqedonisë
KOM: Kisha Ortodokse Maqedonase
Kryqi i Kuq: Kryqi i Kuq i Republikës së Maqedonisë
LGM: Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë
LSDM: Lidhja Socialdemokrate e Maqedonisë
LSHPM: Lidhja e Shoqatave të Pensionistëve të Maqedonisë
MCMS: Qendra Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar
MRFP: Fondacioni Zhvillimor Maqedonas për Ndërmarrje
NATO: Organizata e Marrëveshjes Veri-atlantike
OKM: Organizata e Konsumuesve të Maqedonisë
OQ: Organizata qytetare
PDSH: Partia Demokratike Shqiptare
PSUQM: Parlamenti Studentor i Universitetit “Shën Qirili dhe Metodij”
QIQ: Qendra për Iniciativa Qytetare
SOZHM: Këshilli Nacional për Barazi Gjinore
VMRO-DPMNE: Organizata e brendshme revolucionare maqedonase – Partia demokratike për unitet nacional maqedonas

PARATHËNIE

Besimi në njerëzit, institucionet dhe në shoqërinë civile është parakusht i rëndësishëm për inkuadrimit qytetarëve në organizatat e shoqërisë civil. Ky është një nga faktorët që ndikojnë në kontekstin socio-kulturor, ku veprojnë organizatat qytetare. Gjithashtu MCMS u përcaktua për “planifikim (dhe evokim) të bazuar në fakte”. Për këto shkaqe, duke filluar nga viti 2006 MCMS hulumton besimin, si dhe qëndrimet dhe njohjen e organizatave qytetare nga ana e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë.

Në këtë raport janë prezantuar rezultatet nga anketa e katërt në ekzemplar reprezentues nacional, të zbatuar në dhjetor të vitit 2010. Tre anketat e para u realizuan në vitin 2006, 2007 dhe 2008, ndërsa rezultatet u prezantuan në raportet hulumtuese. Në raportin e sivjetmë përsëri janë dhënë më shumë indekse për përcjelljen e besimit, me të cilat do të lehtësohen analizat e trendeve. Ndryshim është bërë me prezantimin e nivelit të besimit në institucionet dhe në shoqërinë civile në bazë etnike dhe sipas simpatizuesve të partive politike.

Me përsëritjen periodike të raportit dhe lehtësimin e përcjelljes së trendeve të besimit në Republikën e Maqedonisë, mendojmë se e kemi përmirësuar përdorimin e këtij raporti.

MCMS beson se raporti “Besimi në Maqedoni” do të jetë i dobishëm si për organizatat qytetare, ashtu edhe për aktorët tjerë në shoqëri.

MCMS

INDEKSET

Besimi i përgjithshëm	2010		2008	2007	2006
Njerëz	9,7	- ¹	23,1	-	-
Besimi në institucionet					
Shteti	38,7	↓↓	48,1	38,6	29,2
Sektori afarist (sektori privat)	46,7	↔	47,0	51,9	49,8
Sektori civil (joqeveritar)	48,1	↑↑	41,7	45,3	48,1
Partitë politike	23,3	↓↓	29,8	23,1	22,3
Mediumet	40,4	↓↓↓	53,6	52,6	56,7
Bashkësia ndërkombëtare	49,1	↑↑	42,8	47,3	44,5
Indeksi i besimit në institucionet	41,0	↔	43,9	43,1	41,7
Besimi në sektorin shtetëror					
Kryetari i Republikës së Maqedonisë	37,5	↔	35,6	35,1	33,1
Kuvendi i Republikës së Maqedonisë	34,4	↓	38,0	32,6	28,3
Qeveria e Republikës së Maqedonisë	36,8	↓↓↓	51,0	44,6	26,6
Vetëqeverisja lokale	41,4	↓	44,7	44,8	45,5
Gjyqësia e Republikës së Maqedonisë ²	30,4	↑↑	21,2	21,1	23,8
Institucionet arsimore	62,1	↓	65,8	68,5	65,6
Organizatrat shëndetësore ³	50,7	↓	55,1	-	-
Institucionet për mbrojtje sociale	39,5	-	-	-	-
Ndërmarrjet komunale ⁴	42,1	↑	38,8	-	-
Armata e Republikës së Maqedonisë	62,9	↔	64,6	64,4	-
Policia e Republikës së Maqedonisë	52,1	↓	56,6	57,3	-
Indeksi i besimit në institucionet e sektorit shtetëror	44,5	↔	47,1	46,1	37,2
Besimi në sektorin afarist					
Ndërmarrjet e mëdha	50,8	↑↑	45,7	47,9	65,8
Të mesme dhe të vogla	51,8	↔	48,9	53,1	57,2
Miro (familjare)	59,3	↔	59,9	66,2	52,0
Bankat	59,3	-	-	-	-
Indeksi i besimit në organizatat e sektorit afarist	55,3	↑	51,5	55,7	58,3
Besimi në sektorin civil					
Organizatrat qytetare	42,5	↔	41,2	45,4	50,3
Kishat dhe bashkësitë fetare	62,9	↔	65,6	65,6	68,4
Sindikatat	25,3	↑↑	20,1	17,9	21,9
Odat ekonomike	28,5	↑↑	23,3	24,3	29,9
Oranizatrat e punëdhënësve	27,2	-	-	-	-
Indeksi i besimit në organizatat e sektorit civil	37,3	↔	37,6	38,3	42,6
Besimi në bashkësinë ndërkombëtare					
Bashkimi Evropian	57,8	-	-	-	-
Kombet e Bashkuara	61,1	-	-	-	-
NATO	60,5	-	-	-	-
Indeksi i besimit në institucionet e bashkësisë ndërkombëtare	59,8	-	-	-	-
Besimi në profesionet					
Nëpunësit shtetëror	34,8	-	-	-	-
Gjykatësit	28,8	↑↑	20,7	25,5	-
Doganierët	28,7	↔	27,3	17,7	-
Policët	43,5	↓↓	51,3	50,2	-
Arsimtarët, profesorët	66,6	↓	71,1	64,7	-
Mjekët	64,9	↔	66,8	54,5	-
Personat fetar, klerikët	53,8	↔	54,0	54,9	-
Konsultantët afaristë, biznes	41,1	↔	41,4	40,4	-
Indeksi i besimit në profesionet	45,3	↔	47,5	51,3	-

¹ Në vitin 2008 u shtrua pyetja a mund tu besohet shumicës së njerëzve, derisa në vitin 2010 nëse mund tu besohet njerëzve

² Në vitin 2007 dhe 2008 u pyet për besimin në gjyqësinë në Republikën e Maqedonisë

³ Në vitin 2007 dhe 2008 u pyet për besimin në institucionet publike shëndetësore

⁴ Në vitin 2007 dhe 2008 u pyet për besimin në ndërmarrjet komunale publike

10 organizata më të suksesshme qytetare
2010 – Kryqi i Kuq, Megjashi, El Hilal, Most, FISHHM, Zgjohu, Polio plus, MCMS, LSHPM, KHDNJ
2008 - Kryqi i Kuq, Most, FISHHM, El Hilal, LOGM, Megjashi, Transparenca Maqedoni, MCMS, KHDNJ, LSHPM

Indekset e organizatave të njohura qytetare në përgjigje të prioriteteve shoqërore	2010	2008	2007	2006
Njohja e organizatave qytetare të cilat kontribuojnë në luftën kundër varfërisë				
Pesë organizatat e para: 2010 - Kryqi i Kuq, El Hilal, MCMS, FISHHM, Fondacioni Renova 2008 - Kryqi i Kuq, El Hilal, FISHHM, Kalliri i Mirësisë, Megjashi	38,3 (↓↓↓)	52,2	29,9	37,8
Njohja e organizatave qytetare të cilat kontribuojnë në zhvillimin e NVM, zhvillimi ekonomik, punësimi ⁵				
Pesë organizatat e para: 2010 – MRFP 2008 – FISHHM, MRFP, ESE, CIRa, MCMS	9,5 (↔)	11,4	3,5	-
Njohja e organizatave qytetare të cilat kontribuojnë në zhvillimin lokal dhe rural				
Pesë organizatat e para: 2010 - BNJVL	13,4 -	-	-	-
Njohja e organizatave qytetare të cilat kontribuojnë në zhvillimin e demokracisë dhe të drejtat e njeriut				
Pesë organizatat e para: 2010 - KHDNJ, Megjashi, Most, Zgjohu, FISHHM	28,8 -	-	-	-
Njohja e organizatave qytetare të cilat punojnë në fushën e luftës kundër korrupsionit				
Pesë organizatat e para: 2010 - Transparenca Maqedoni, KHDNJ, Most, SHGM, Zgjohu 2008 - Transparenca Maqedoni, KHDNJ, Most, Zero korrupsion-Transparenca, MCMS	14,1 (↓↓)	22,3	12,0	15,3
Njohja e organizatave qytetare të cilat punojnë në fushën e zhvillimit të shoqërisë civile				
Pesë organizatat e para: 2010 - FISHHM, MCMS, Zgjohu, Megjashi, Most 2008 - Most, KHDNJ, FISHHM, MCMS, Transparenca Maqedoni	17,8 (↓↓↓)	36,0	23,6	29,1
Njohja e organizatave qytetare të cilat kontribuojnë në ndërtimin e shoqërisë multietnike				
Pesë organizatat e para: 2010 - MCMS, Zgjohu, Forumi Rinor Islam, FISHHM, SHGM	13,2 -	-	-	-
Indekset e njohjes dhe qëndrimeve për njëzet e pesë organizatat qytetare				
Njohja në shikim të parë të organizatave qytetare	61,9 (↔)	62,3	63,9	58,7
Njohja e organizatave qytetare	31,5 (↔)	29,2	30,8	28,3
Besimi në organizatat qytetare	23,7 (↔)	21,4	23,5	22,4
Qëndrime pozitive/negative për organizatat qytetare	4,9 -	3,5	4,4	4,3
10 organizatat e para qytetare në shikim të parë	82,3 (↔)	82,2	83,2	81,6
10 organizatat e para qytetare që njihen	48,5 (↔)	46,6	47,2	45,6
10 organizatat e para në besim	37,9 (↑)	34,7	36,9	36,6
10 qëndrimet e para pozitive/negative për organizatat qytetare	8,4 -	5,5	7,4	6,8
Indekset e njohjes së personaliteteve nga organizatat qytetare				
Njohja e personaliteteve nga shoqëria civile	-	-	48,9	42,6
Besimi në personalitetet nga shoqëria civile	-	-	28,4	25,2
Besimi/mosbesimi në personalitete nga shoqëria civile	-	-	1,5	1,5

Legjenda

↔	pa ose me ndryshime të parëndësishme	Pa ose me ndryshime të parëndësishme = 0 – 3 pikë përqindësh Të vogla = 3,01 – 5 pikë përqindësh Të matura = 5,01 – 10 pikë përqindësh Të mëdha = mbi 10 pikë përqindësh
↑	rritje e vogël	
↓	rënie e vogël	
↑↑	rritje e matur	
↓↓	rënie e matur	
↑↑↑	rritje e madhe	
↓↓↓	rënie e madhe	

⁵ Në vitin 2007 dhe 2008 u pyet për kontributin në zhvillimin e ekonomisë

HYRJE

Në këtë raport janë analizuar rezultatet nga anketa “Besimi në institucionet dhe në shoqërinë civile në Republikën e Maqedonisë”, e cila u realizuar për të katërtën herë në ekzemplar reprezentues nacional të qytetarëve të Republikës së Maqedonisë.

Qëllimi i këtij hulumtimi ishte të kontrollohet besimi i qytetarëve në institucionet dhe në shoqërinë civile.

Qendra Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar (MCMS) ia besoi anketën për opinion publik, mbi të cilin bazohet ky raport, Institutit për Hulumtime Sociologjike dhe Juridike-Politike (IHSJP), përgjegjësia e të cilit ishte edhe rregullsia metodologjike e anketës.

Termet dhe definicionet

Në opinionin maqedonas dhe në rrethet eksperte nuk ekziston kuptim i ndërsjellë i konceptit (definicion) të shoqërisë civile. Në këtë raport është përdorur definicioni nga Civikus – Indeksi i shoqërisë civile në Maqedoni (MCMS, 2009). Ky definicion thotë “Shoqëria civile është pjesë e hapësirës shoqërore jashtë familjes, shtetit dhe tregut, i cili është krijuar nga ana e individëve dhe aksioneve kolektive, organizatave dhe institucioneve me qëllim të arritjes së interesave të përbashkëta”.

Sipas këtij definicioni në shoqërinë civile janë përfshirë shoqatat dhe fondacionet, odat ekonomike, organizatat e punëdhënësve, sindikatat, partitë politike dhe bashkësitë fetare.

Metodologjia dhe qasja

Hulumtimi është realizuar me anketë në terren – intervista “sy më sy” në amvisëritë në dhjetor të vitit 2010, në ekzemplar reprezentues prej 1.300 të anketuarve nga ana e IHSJP.

Pyetëtori

Pyetësorët për anketën janë ato që u përdorën në tre anketat e para (2006, 2007 dhe 2008) të ndryshuara në bazë të përvojave dhe hulumtimeve globale për normat socio-kulturore. Pyetësorët janë përgatitur nga autorët.

Për arritjen e qëllimeve të hulumtimit, me pyetësin janë përfshirë këto variabël:

- Besimi – i përgjithshëm (normat socio-kulturore);
- Besimi në shoqërinë civile;
- besimi në organizatat qytetare;
- Njohja dhe mendimet për organizatat qytetare në Maqedoni;
- Karakteristikat socio-demografike.

Ekzemplari

Anketa u realizua në dhjetor të vitit 2010 në ekzemplar reprezentues prej 1.300 të anketuar. Korniza e popullatës në ekzemplar ishte popullata më e vjetër se 18 vjet, ndërsa kriteret për reprezentativitet ishin: gjinia, përkatësia etnike, mosha, vendi i banimit dhe rajoni.

Prej 1.300 të anketuarve, 49,5% ishin gra, ndërsa 50,5% meshkuj, në raport me përfaqësimin etnik maqedonasit ishin të përfaqësuar me 63,4%, ndërsa shqiptarët me 24,9%, bashkësitë tjera etnike ishin të përfaqësuar me 11,7%. Në raport me vendin e banimit, popullata fshatare ishte e përfaqësuar me 39%, derisa ajo e qytetit me 61% (qyteti i Shkupit me 20,8%). Pasqyra e plotë e ekzemplarit është dhënë në shtojcën 2.

Në raport, në vende të caktuara shkruan se dallimet në qëndrimet në bazë etnike reflektohen në dallimet në bazë të vendit të banimit (rurale/urbane) dhe te rajonet gjeografike, si dhe te simpatizuesit e partive politike. Kjo ka të bëjë me pjesëmarrjen më të madhe të dy bashkësive më të mëdha (maqedonasit etnike dhe shqiptarët etnik) në ekzemplarin sipas vendit të banimit (rurale/urbane) rajonet gjeografike dhe simpatizuesit e partive politike, se sa në ekzemplarin nacional. Në ekzemplar pjesëmarrja e shqiptarëve etnik është 24,9%, ndërsa pjesëmarrja e tyre është më e lartë në rajonet rurale (40,4%), në rajonin e Pollogut (63,7%) dhe në BDI (91,9%). Në mënyrë adekuate, qëndrimet e shqiptarëve etnik ndikojnë në qëndrimet në rajonet rurale, rajonin e Pollogut dhe BDI.

Përpunimi dhe prezantimi i rezultateve

Të dhënat e grumbulluara janë përpunuar me shpeshti dhe proporcion të përgjigjeve. Të dhënat janë me besueshmëri prej 95% dhe me gabim prej +/- 5%. Rezultatet janë prezantuar në grafik në nivel të gjithë ekzemplarit. Përveç me grafike, të dhënat janë prezantuar edhe në numra. Krahas numrave është prezantuar trendi në raport me vitin paraprak për përgjigjet afirmative (p.sh. ka besim), për ato të dhëna të cilat mund të krahasohen me hulumtimin nga viti 2008. Legjenda e simboleve është si vijon:

↔	pa ose me ndryshime të parëndësishme	Pa ose me ndryshime të parëndësishme = 0 – 3 pikë përqindësh Të vogla = 3,01 – 5 pikë përqindësh Të matura = 5,01 – 10 pikë përqindësh Të mëdha = mbi 10 pikë përqindësh
↑	rritje e vogël	
↓	rënie e vogël	
↑↑	rritje e matur	
↓↓	rënie e matur	
↑↑↑	rritje e madhe	
↓↓↓	rënie e madhe	

Për përmirësimin e përdorimit të raportit dhe mundësinë për analizë dhe krahasim janë përdorur edhe indekset (treguesit). Në tabelën më poshtë janë dhënë sqarime për indekset për organizatat qytetare.

Pakicë e parëndësishme përdoret për përgjigjet më pak se 10% nga ekzemplari, pakicë e vogël për 11% deri 30%, pakicë për 30% deri 50%, shumicë për 51% deri 70% dhe shumicë e madhe për më shumë se 70%.

Në raport nuk janë komentuar analizat socio-demografike për bashkësitë etnike me numër të vogël dhe partitë politike me më pak simpatizues, për shkak të pjesëmarrjes së tyre të vogël në ekzemplarin nacional.

Në raport në tabela dhe grafike të caktuara nuk janë prezantuar rezultatet për “nuk e di” dhe “pa përgjigje”, për shkak se shumica e përgjigjeve nuk është 100%. Kjo është bërë për nevojat e prezantimit më të thjeshtë të rezultateve.

Grupi punues

Në MCMS grupin punues e përbëjnë: Sasho Klekovski, Emina Nuredinoska, Gonca Jakovleska dhe Daniella Stojanova.

Indeksi i besimit të përgjithshëm	
Indeksi i besimit të përgjithshëm dhe besimit në institucionet sipas sektorëve	= Σ ka besim / numri i institucioneve
Indeksi i besimit në profesionet	= Σ ka besim / numri i profesioneve
Indeksi i njohjes së organizatave qytetare në përgjigjen e prioritetëve shoqërore	
Indeksi i njohjes së organizatave qytetare të cilat punojnë në fushën e varfërisë, luftën kundër korrupsionit, zhvillimin e ekonomisë, cilat punojnë në zhvillimin e shoqërisë civile etj.	= Σ di
Indekse të njohjes dhe qëndrime për njëzet e pesë organizatat qytetare	
Njohja e organizatave qytetare në shikim të parë	= Σ kam dëgjuar/ numri i organizatave
Njohja e organizatave qytetare	= Σ di/ numri i organizatave
Besimi në organizatat qytetare	= Σ mendim / numri i organizatave
Qëndrime pozitive/negative për organizatat qytetare	= Σ herësi i qëndrimeve pozitive dhe negative/ numri i organizatave
10 organizatat e para qytetare në shikim të parë	= Σ kamë dëgjuar/ 10 organizatat e para
10 organizatat e para qytetare që njihen	= Σ di/10 organizatat e para
10 organizatat e para në besim	= Σ mendim pozitiv/ 10 organizatat e para
10 qëndrimet e para pozitive/negative për organizatat qytetare	= Σ herësi i qëndrimeve pozitive negative/ 10 organizatat e para

I. BESIMI PËRGJITHSHËM DHE BESIMI NË INSTITUCIONET

Hyrje


Besimi është komponentë kyçe e kapitalit social. Në përgjithësi, mund të identifikohen tre tipa kryesore të besimit: besimi në të ngjashmit, besimi i përgjithshëm dhe besimi në institucionet. I pari është besimi social në të ngjashmit, besim i artikuluar ose besim i personalizuar. Ky është besimi brenda në marrëdhëniet e bazuara ose rrjetet sociale (familja, miqtë, fqinjët etj.). I dyti, besimi i përgjithshëm ose besimi social, duke përfshirë besimin në të huajt. Besimi i tretë është besimi institucional, i cili referon në besimin e bazuar në institucionet formale të sundimit dhe të shoqërisë.

Besimi i përgjithshëm

Gjatë hulumtimit të deritanishëm nuk është shtruar pyetja për besimin në familje, kjo është supozuar si ekzistuese, për shkak të pothuaj 100% besim në hulumtimet paraprake.

Besimi i përgjithshëm është 9,7%, ndërsa 83,4% të qytetarëve mendojnë se duhet të jesh i kujdesshëm. Kjo paraqet zvogëlim të besimit të përgjithshëm, i cili në vitin 2008 ishte 23,1%, ndërsa 76,8% kanë menduar se duhet të jesh i kujdesshëm me njerëzit.

Grafiku I.1. Besimi në njerëzit




Në shkallën prej 1 deri 10, ku 1 është "Shumica e njerëzve do të përpiqeshin të më shfrytëzojnë", ndërsa 10 është "Shumica e njerëzve do të përpiqeshin të veprojnë në mënyrë të ndershme", vlera mesatare e qëndrimeve të qytetarëve është 4,1.

Besimi në institucionet

Me besimin në institucionet është hulumtuar besimi sipas qasjes tre sektoriale: shteti, sektori afarist (privat) dhe civil. Mediumet dhe partitë politike për shkak të mundësisë që ti takojnë më shumë sektorëve janë ndarë veçmas. Është hulumtuar edhe besimi në bashkësinë ndërkombëtare.

Grafiku I.2. Sa besim keni në:



Në vitin 2010 asnjë sektor nuk e ka besimin e shumicës, derisa në vitin 2008 e kishin mediumet. Afër shumicës është sektori afarist dhe civil, si dhe bashkësia ndërkombëtare. Edhe më tej besim më të vogël qytetarët kanë në partitë politike.

Besimi në shtet që ishte në trend të rritjes prej 29,2% në vitin 2006, përmes 38,6% në vitin 2007 deri 48,1% në vitin 2008, tani është zvogëluar në 38,7%, sa ka qenë në vitin 2007. Zvogëlimi kryesisht ka të bëjë me besimin e zvogëluar ndaj shtetit mes shqiptarëve etnik.

Tabela I.1. Besimi në shtet te maqedonasit etnik dhe te shqiptarët etnik në vitin 2010, 2008 dhe 2006

Viti	Maq. etn.	Shqi. etn.	Gjithsej
2010	48,2 %	16,0 %	38,7 %
2008	51,8 %	42,1 %	48,1 %
2006	26,5 %	36,2 %	29,2 %

Dallime në qëndrime mes maqedonasve etnike dhe shqiptarëve etnik dhe dallimet sipas vendit të banimit (rurale/urbane), simpatizuesve të partive politike dhe rajoneve gjeografike.

Në besimin ndaj sektorit afarist dhe ndaj partive politike më nuk ekzistojnë dallimet varësisht nga përkatësia etnike të cilat ekzistonin në vitin 2008, derisa mbetën dallimet në besimin ndaj bashkësisë ndërkombëtare varësisht nga përkatësia etnike.

Besim më të madh në sektorin afarist kanë të punësuarit në sektorin privat (54,7%) dhe studentët (62,2%), qytetarët e klasës më të lartë dhe klasës më të lartë të mesme, si dhe ata me arsim të lartë/sipëror (54,3%).

Në shoqërinë civile besim më të madh kanë të rinjtë të moshës prej 18 deri 29 vjet (56,1%), të punësuarit në sektorin publik (59,6%), studentët (58,2%) dhe qytetarët me arsim të lartë/sipëror (56%). Besimin më të madh në shoqërinë civile të cilën e kishin shqiptarët etnik në raport me maqedonasit etnik në vitin 2006, zvogëlohet në vitin 2008 dhe në vitin 2010 ka ndryshim – besim më të madh kanë maqedonasit etnik (49,3%) në raport me shqiptarët etnik (45,7%).

Edhe dallimet etnike në besimin ndaj partive politike përjetuan kthesë në vitin 2010.

Tabela I.2. Dallimet etnike në besimin ndaj partive politike në vitin 2010 dhe 2008

Viti	Maq. etn.	Shqi. etn.	Gjithsej
2010	25,4 %	16,4 %	23,3 %
2008	26,2 %	42,3 %	29,8 %

Simpatizuesit e VMRO-DPMNE janë me besim më të madh në partitë politike. Besimi ndaj partive politike mes qytetarëve të cilët nuk janë simpatizues të partive politike është në nivel shumë të ulët prej 11,1%.

Tabela I.3. Dallimet në besimin ndaj partive politike mes (jo)simpatizuesve të tyre

	VMRO DPMNE	LSDM	BDI	PDSH	Demo. Re	Tjetër	Nuk. simp.	Gjithsej
Ka besim në partitë politike	45,0 %	28,1 %	19,2 %	19,7 %	21,0 %	34,0 %	11,1 %	23,3 %

Besimi ndaj bashkësisë ndërkombëtare është i ndarë mes grupeve të ndryshme shoqërore, dallim ka vetëm në bazë etnike. Besimi mes maqedonasve etnik është rritur në 43,1%, prej 32,9% në vitin 2008.

Tabela I.4. Dallimet etnike në besimin ndaj bashkësisë ndërkombëtare në vitin 2010 dhe 2008


Viti	Maq. etn.	Shqi. etn.	Gjithsej
2010	43,1 %	65,4 %	49,1 %
2008	32,9 %	68,2 %	42,8 %

Për bashkësinë ndërkombëtare kanë perceptime të ngjashme edhe qytetarët që janë simpatizues të LSDM dhe të VMRO-DPMNE prej 44,3%, gjegjësisht 42,2%, në raport me vitin 2008 kur ka qenë 38,6%, gjegjësisht 37,3%.

Besimi në sektorin shtetëror

Besimi ndaj shtetit është hulumtuar edhe përmes besimit në institucionet kryesore të cilat e përbëjnë si Kryetari, Kuvendi, Qeveria, gjyqësia, vetëqeverisja lokale dhe shërbimet kryesore të cilat i siguron ai, si mbrojtja (armata), policia, institucionet arsimore dhe shëndetësore dhe ato për mbrojtje sociale, si dhe ndërmarrjet komunale.

Grafiku I.3. Besimi në sektorin shtetëror



Armata (62,9%), institucionet arsimore (62,1%), policia (52,1%) dhe institucionet shëndetësore (50,7%) e kanë besimin e shumicës, si dhe në vitin 2008. Qytetarët kanë besim më të vogël në Kuvend (34,4%) dhe në gjyqësi (30,4%). Te gjyqësia nuk ka dallime në besimin te grupet e ndryshme socio-demografike.

Besimi në kryetarin e shtetit

Besimi në kryetarin e shtetit është 37,5% (35,6% në vitin 2008 dhe 35,1% në vitin 2007). Edhe pse në nivelin e besimit nuk ka ndryshime, me ndërrimin pas zgjedhjeve në vitin në 2009 kur në vend të z. Cërvenkovski u zgjidh z. Ivanov, ka ndryshim në mbështetjen sipas grupeve të caktuara socio-demografike.

Tabela I.5. Besimi në kryetarin në bazë etnike dhe partiake në vitin 2010 dhe 2008

Viti	Maq. etn.	Shqi. etn.	VMRO-DPMNE	LSDM	BDI	PDSH	Nuk. simp.	Gjithsej
2010	48,9 %	9,0 %	74,7 %	25,9 %	9,1 %	6 %	32,3 %	37,5 %
2008	40,4 %	18,7 %	24,3 %	72,9 %	-	-	38,9 %	35,6 %

Besimi në Kuvend

Besimi në Kuvendin është 34,5% (38% në vitin 2008). Besim në Kuvend kanë 40,2% të maqedonasve etnik dhe 18,5% të shqiptarëve etnik. Kuvendi ka besim prej 66,1% mes simpatizuesve të VMRO-DPMNE dhe 27% mes atyre të LSDM.

Besimi në Qeveri

Qeveria ka besim prej 36,8%, që është ulje nga viti 2008 dhe 2007 kur ka qenë 51%, gjegjësisht 44,6%, por është më i lartë nga besimi në vitin 2006 kur ka qenë 26,6%.

Tabela I.6. Besimi në Qeveri në bazë etnike dhe partiake në vitin 2010 dhe 2008

Viti	Maq. etn.	Shqi. etn.	BMPO ДПМНЕ	LSDM	BDI	PDSH	Nuk. simp.	Gjithsej
2010	44,1 %	18,5 %	77,2 %	17,3 %	22,2 %	14,0 %	29,0 %	36,8 %
2008	56,2 %	38,5 %	74,9 %	35,9 %	35,4 %	29,0 %	46,0 %	51,0 %

Në Qeverinë kanë besim të njëjtë edhe qytetarët religjioz (37,6%) dhe qytetarët jo religjioz (33,9%). Besim më të lartë kanë më të vjetrit se 65 vjet (44,3%). Besimi bien me zvogëlimin e statusit social – nga klasa më e lartë (44,4%), përmes klasës më të ulët të mesme (39,1%), deri te klasa më e ulët (28,9%).

Tabela I.7. Besimi në Qeveri sipas status të punës në vitin 2010 dhe 2008

Viti	Spektori publik	Spektori privat	Bujk	Student	Amvis	I papun.	Pension.	Gjithsej
2010	42,8 %	39,7 %	36,8 %	37,8 %	19,0 %	30,2 %	42,8 %	36,8 %
2008	51,1 %	51,3 %	54 %	50,3 %	45,7 %	50,3 %	61,3 %	51,0 %

Besimi në shërbimet shtetërore

Armata dhe policia kanë besim te shumica e qytetarëve.

Tabela I.8. Besimi në policinë në bazë etnike në vitin 2010, 2008 dhe 2007

Viti	Maq. etn.	Shqi. etn.	Gjithsej
2010	59,5 %	31,5 %	52,1 %
2008	62,6 %	42,0 %	56,6 %
2007	52,1 %	45,6 %	57,3 %

Në besimin ndaj institucioneve arsimore dhe shëndetësore dhe ato për mbrojtje sociale, nuk ka dallime më të mëdha mes grupeve të ndryshme socio-demografike.

Besimi në vetëqeverisjen lokale

Vetëqeverisja lokale ka besim mes 41,4% të qytetarëve, që është ruajtur niveli i mëparshëm i besimit prej 44,4% në vitin 2008.

Në vitin 2010 në raport me vitin 2008 vjen deri te konverzioni i besimit mes maqedonasve etnike dhe shqiptarëve etnik, gjegjësisht tani maqedonasit etnik kanë besim më të lartë.

Tabela I.9. Besimi në vetëqeverisjen lokale në bazë etnike në vitin 2010 dhe 2008

Viti	Maq. etn.	Shqi. etn.	Gjithsej
2010	44,4 %	33,6 %	41,4 %
2008	41,7 %	55,6 %	44,7 %

Besimi në vetëqeverisjen lokale ka rritje të madhe në rajonin lindor, juglindor dhe verilindor, ndërsa zvogëlim në rajonet tjera, me përjashtim të rajonit të Shkupit, ku besimi është stabil.

Tabela I.10. Besimi në vetëqeverisjen lokale në rajonet në vitin 2010 dhe 2008

Viti	I Shkupit	Juglindor	Lindor	Verilindor	I Vardar.	Jugperën.	Pollog	Pellagoni.	Gjithsej
2010	41,7 %	60,7 %	46,8 %	41,8 %	29,9 %	29,9 %	36,8 %	43,2 %	41,4 %
2008	41,0 %	49,3 %	24,4 %	32,3 %	43,4 %	41,5 %	64,6 %	57,4 %	44,4 %

Në ndërmarrjet komunale kanë besim 42,1%, që është rritje e vogël në raport me 38,8% në vitin 2008.


Tabela I.11. besimi në ndërmarrjet komunale në rajonet në vitin 2010 dhe 2008

Viti	I Shkupit	Juglindor	Lindor	Verilindor	I Vardar.	Jugperën.	Pollog	Pellagoni.	Gjithsej
2010	42,5 %	53,0 %	50,0 %	32,7 %	48,3 %	34,2 %	35,9 %	44,6 %	42,1 %
2008	46 %	51,4 %	30,8 %	39,7 %	38,7 %	45,1 %	34,3 %	43,7 %	38,8 %

Besimi në bashkësinë ndërkombëtare

Besimi ndaj bashkësisë ndërkombëtare është hulumtuar edhe përmes besimit në tre organizatat ndërkombëtare dhe/ose unione: Kombet e Bashkuara (KB), Bashkimi Evropian (BE) dhe Organizata e Marrëveshjes Veri-Atlantike (NATO).

Grafiku I.4. Besimi në bashkësinë ndërkombëtare



Besimi në KB, BE dhe NATO është ngjashme, prej 57,8% deri 61,1%.


Mbi besimin në tre organizatat ndikon përkatësia etnike, ndërsa ajo ka ndikim në rajonet gjeografike dhe te simpatizuesit e partive politike.

Tabela I.12. Besimi në KB, BE dhe NATO në bazë etnike dhe partiake në vitin 2010

Organizata	Maq. etn.	Shqi. etn.	VMRO DPMNE	LSDM	BDI	PDSH	Nuk. simp.	Gjithsej
KB	54,7 %	77,5 %	56,4 %	56,8 %	81,8 %	78,8 %	59,0 %	61,1 %
BE	48,1 %	83,0 %	50,2 %	48,6 %	87,9 %	83,3 %	55,8 %	57,8 %
NATO	60,8 %	86,1 %	52,9 %	56,6 %	91,9 %	89,4 %	58,3 %	60,5 %

Besimi në sektorin afarist

Në besimin e sektorit afarist është hulumtuar besimi në ndërmarrjet mikro (familjare), të vogla dhe të mesme, si dhe ndërmarrjet e mëdha. Besimi i përgjithshëm (grafiku 1.2.) edhe besimi në ndërmarrjet e ndryshme është stabile.



Grafiku I.5. Besimi në sektorin afarist


Qytetarët, si edhe në hulumtimet parapake shprehin besim të madh në mikro ndërmarrjet dhe bankat përkundër ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, gjegjësisht ndërmarrjeve të mëdha.

Besimi në profesione

Shumica e qytetarëve kanë besim në “mësuesit, mjekët dhe priftin/hoxhën”, gjegjësisht në arsimtarët/profesorët, mjekët dhe personat fetar. Besim më të vogël kanë gjykatësit (28,8%) dhe doganierët (28,7%).

Gjykatësit, edhe pse janë në fund të listës së besimit, kanë rritje të besimit për 8,1 pikë përqindësh në raport me vitin 2008 kur besim te ata kanë pasur 20,7%.

Grafiku I.6. Besimi në profesionet



Në personat fetarë besim kanë shumica e qytetarëve të cilët janë të krishterë (51,8%) dhe myslimanë (60,5%).

Besimi në profesionet kryesisht e ndjek besimin në institucionet.

Tabela I.13. Krahasimi i besimit në institucionet dhe profesionet adekuate

	Institucioni	Profesioni
Gjyqësi/ gjykatësit	30,4 %	28,8 %
Arsimi/ profesorët	62,1 %	66,6 %
Shëndetësi/ mjekët	50,7 %	64,9 %
Policia/ policët	52,1 %	43,5 %
Bashkësitë fetare/ personat	62,9 %	53,8 %

Si edhe hulumtimi në vitin 2008, te dy profesione ka dallim: besimi në mjekët (64,9%) është më i lartë se besimi në institucionet shëndetësore (50,7%), ndërsa besimi te personat fetar (53,8%) është më i ulët se besimi në kishat dhe bashkësitë fetare (62,9%).

Besimi dhe ndikimet socio-demografike

Besimi në nivel nacional është në lidhje të caktuar me grupet socio-demografike. Më shumë le përshtypje ndikimi i përkatësisë etnike dhe përkatësisë partiake, gjegjësisht simpatizuesit e partive politike, që në mënyrë përmbledhëse është shfaqur në tabelën 1.14, ndërsa më hollësisht në shtojcën 1.

Marrë në përgjithësi, maqedonasit etnik dhe simpatizuesit e VMRO-DPMNE kanë besim më të lartë. Përfundimisht është besimi në bashkësinë ndërkombëtare ku shqiptarët etnik dhe simpatizuesit e BDI, PDSH dhe Demokracisë së Re kanë besim më të lartë.

Në besimin në sektorin afarist dhe civil dhe diku në profesionet, nuk ka dallime më të mëdha mes bashkësive etnike dhe simpatizuesve të partive politike.

Pjesa më e madhe e simpatizuesve të VMRO-DPMNE dhe LSDM janë maqedonas etnik, ndërsa të BDI, PDSH dhe DR janë shqiptarë etnik. Besimi mes simpatizuesve politik ku shumica janë shqiptarë etnik nuk ka dallime dhe duket se përkatësia etnike është ajo që ndikon, e jo partitë politike. Nga ana tjetër, besimi mes simpatizuesve të partive politike ku shumica janë maqedonas etnik, ka dallime më të mëdha (besimi në sektorin shtetëror/profesionet) dhe duket se krahas përkatësisë etnike, ndikim ka edhe përkatësia partiake.

Tabela I.14. Pasqyrë e besimit sipas përkatësisë etnike dhe sipas simpatizuesve të partive politike

Indeksi i besimit/grupi socio-demografik	Gjithsej	Maq. etn.	Shqi. etn.	VMRO-DPMNE	LSDM	BDI	PDSH	Dem. Re	Nuk. simp
Besimi në institucionet (gjithsej)	41,0	42,7	37,5	52,0	41,1	38,9	36,9	37,9	36,9
Besimi në sektorin shtetëror	44,9	49,4	31,1	63,7	37,6	31,0	32,0	23,9	39,0
Besimi në bashkësinë ndërkomb.	59,8	51,2	82,2	53,2	53,3	86,9	84,8	78,8	57,7
Besimi në sektorin afarist	55,3	56,2	52,0	59,1	56,6	47,2	49,6	40,9	56,5
Besimi në sektorin civil	39,8	40,0	37,3	40,8	36,7	37,0	35,5	31,5	37,1
Besimi në profesionet	45,3	45,3	44,7	52,1	41,1	45,2	43,2	40,1	44,3

Përfundime

Besim i ulët ose mosbesim i matur?

Qytetarët kanë besim të ulët të përgjithshëm (9,7%). Ky rezultat është në kundërshtim me vlerën mesatare prej 4,1 të shkallës prej 1 deri 10, ku q është “Shumica e njerëzve do të përpiqeshin të më shfrytëzojnë”, ndërsa 10 është “Shumica e njerëzve do të përpiqeshin të veprojnë në mënyrë të ndershme”. Dallimet mund të bëjnë me dallimin e vogël në formulimin e dy pyetjeve – “mund ti besohet njerëzve” është më e gjerë dhe formulimin më përfshirës se nga “shumica e njerëzve do të përpiqeshin të veprojnë në mënyrë të ndershme”.

Besim stabil në institucionet

Besimi në institucionet është stabil – indeksi i besimit është 41. Indeksi i besimit në institucionet ka ndryshime jo aq të mëdha: në vitin 2008 ka qenë 42,9, ndërsa në vitin 2010 është 41. Stabiliteti është ruajtur, edhe krahas rënies së madhe në besimin e medimeve (53,6% në vitin 2008, në 40,4% në vitin 2010) dhe rënie të matur të besimit në shtet dhe në partitë politike, për shkak të rritjes së besimit në sektorin civil dhe bashkësinë ndërkombëtare.

Besim stabil në sektorin shtetëror – Armata, institucionet arsimore, policia, institucionet shëndetësore me besim nga shumica e qytetarëve

Besimi në sektorin shtetëror është stabil dhe indeksi i besimit është 44,5.

Besim në armatë, institucionet arsimore, policinë, institucionet shëndetësore ka shumica e qytetarëve, edhe krahas zvogëlimit të besimit në tre të fundit.

Rritje e besimit në gjyqësi dhe gjykatësit

Besimi në gjyqësi në vitin 2010 ka qenë 30,4% dhe është rritur për 9,2 pikë përqindësh në raport me vitin 2008. Besimi në gjykatësit është 28,8% dhe është rritur për 8,1 pikë përqindësh në raport me vitin 2008 kur besim te ata kanë pasur 20,7%.

Besim i zvogëluar në Qeverinë dhe medimet

Qeveria ka besim prej 36,8%, që është zvogëluar prej vitit 2008 dhe 2007 kur ka qenë 51%, gjegjësisht 44,6%, ndërsa është më e lartë se besimi në vitin 2006 kur ka qenë 26,6%. Besimi është zvogëluar më shumë mes shqiptarëve etnik, se sa mes maqedonasve etnik, në vitin 2010 në raport me vitin 2008 zvogëlimi është 20 pikë përqindësh, gjegjësisht 12,1 pikë përqindësh.

Besimi në Qeveri është zvogëluar për 14,2 pikë përqindësh, ku përafërsisht është zvogëluar edhe besimi në medimet (13,2 pikë përqindësh). Te medimet nuk ka dallime të rëndësishme socio-demografike.

Besim i lartë në KB, BE dhe NATO dhe rritje e besimit në bashkësinë ndërkombëtare

Besimi në KB, BE dhe NATO është e ngjashme, prej 57,8% deri 61,1%. Besimi në bashkësinë ndërkombëtare është më e madhe për 6,3 pikë përqindësh në raport me vitin 2008.

Për analiza të mëtejshme është pyetja pse besimi në bashkësinë ndërkombëtare (49,1%) është më e ulët në institucionet kryesore, si KB, BE dhe NATO të cilat e përbëjnë këtë bashkësi (59,8%).

Besim i lartë në mikro-ndërmarrjet dhe bankat, rritje te ndërmarrjet e mëdha

Besimi në mikro-ndërmarrjet dhe bankat është e lartë 59,3%. Besimi në ndërmarrjet e mëdha është rritur në vitin 2010 për 5,1 pikë përqindësh në raport me vitin 2008.

Për analiza të mëtejshme është pyetja pse besimi në sektorin afarist (46,7%) është më i ulët nga besimi në institucionet të cilat e përbëjnë këtë sektor (55,3%).

Besimi në “mësuesit, mjekët dhe priftin/hoxhën”

Shumica e qytetarëve kanë besim në “mësuesit, mjekët dhe priftin/hoxhën” gjegjësisht në arsimtarët/profesorët, mjekët dhe personat fetar. Besim më të vogël qytetarët kanë te gjykatësit (28,8%) dhe doganierët (28,7%).

Besimi në të “ngjashmit” ndikon në besimin në institucionet?

Ky dhe hulumtimet e mëparshme kanë treguar se qytetarët e Maqedonisë kanë besim më të lartë në “të ngjashmit”, se sa besimi i përgjithshëm (besimi në “të tjerët” dh “të huajt”). Përkatësia etnike dhe simpatizuesit e partive politike janë dy karakteristika socio-demografike të cilat kanë më së shumti ndikim në besimin në institucionet dhe sektorët. Në grupet ku institucionet perceptohen si simbol i “të ngjashmëve” kanë besim më të lartë dhe anasjelltas. Ilustrim më i mirë është besimi në kryetarin e shtetit dhe ndryshimi i besimit mes simpatizuesve të VMRO-DPMNE dhe LSDM në vitin 2008 dhe 2010, lidhur me ndërrimin e kryetarit në zgjedhjet në vitin 2009 (fq. 11). Te simpatizuesit e BDI, PDSH dhe Demokracia e Re duket se dominon ndikimi i përkatësisë etnike, dhe jo raporti pozitiv/opozitë. Raporti pozitiv/opozitë ndikon në besimin te simpatizuesit e VMRO-DPMNE dhe LSDM, me përjashtim të besimit në bashkësinë ndërkombëtare ku ekziston ndikim i përkatësisë etnike. Në besimin në sektorët, si sektori afarist dhe civil, ku ka llojllojshmëri të madhe, nuk ekziston dallim i madh lidhur me përkatësinë etnike dhe partiake (simpatizues të partive politike).

Shqiptarët etnik me besim të zvogëluar edhe në institucionet në të cilat kishin besim

Në këtë dhe hulumtimet paraprake shqiptarët etnike kanë pasur besim më të ulët nga maqedonasit etnik në institucionet të cilat perceptohen si “simbole” të shtetit dhe interes nacional si Kryetari i Republikës, Qeveria ose Armata. Në vitin 2010 besimi në këto në këto institucione te shqiptarët etnik është zvogëluar. Nga ana tjetër shqiptarët etnik kanë pasur besim më të lartë nga maqedonasit etnik në bashkësinë ndërkombëtare dhe institucionet “e reja” si partitë politike, vetëqeverisja lokale dhe shoqëria civile. Në vitin 2010 ka zvogëlim të besimit edhe në këto institucione dhe për herë të parë shqiptarët etnik kanë besim më të vogël nga maqedonasit etnik. Zvogëlimi i besimit mes shqiptarëve etnik më së miri ilustrohet me zvogëlimin e besimit në partitë politike prej 41,1% në vitin 2006, dhe 42,3% në vitin 2008 në 16,4% në vitin 2010 ose vetëqeverisja lokale nga 58,5% në vitin 2006 dhe 55,6% në vitin 2008 në 33,6% në vitin 2010.

Ky trend mund të jetë tregues i pritjeve të porealizuara mes shqiptarëve etnike nga institucionet “e reja” si partitë politike dhe vetëqeverisja lokale.

Në vitin 2010 shqiptarët etnik akoma kanë besim të lartë në bashkësinë ndërkombëtare.

II. BESIMI NË SHOQËRINË CIVILE


Hyrje

Shoqëria civile në tërësi shënon besim të rritur të matur te qytetarët në raport me anketën e realizuar në vitin 2008 dhe e njëjta është 48,1%.

Në këtë pjesë të raportit bëhet pasqyrë më e hollësishme e besimit brenda vetë shoqërisë civile, si dhe të qëndrimeve të qytetarëve për çështje të caktuara lidhur me organizatat qytetare.

Besimi në aktorët e shoqërisë civile

Grafiku II.1. Sa besim kanë në:



Kishat dhe bashkësitë fetare edhe më tej mbeten me besim më të madh mes qytetarëve me shumicë prej 62,9%. Si edhe në vitin 2008 kishat dhe bashkësitë fetare gëzojnë pothuaj 20 pikë përqindësh besim më të madh se sa organizatat qytetare (shoqatat dhe fondacionet). Sindikatat dhe odat ekonomike shënojnë rritje të matur, por akoma kanë besim nga një pakicë e vogël e qytetarëve.

Besimi në organizatat qytetare (shoqatat dhe fondacionet) është rritur në mënyrë të dukshme në raport me vitin 2008, por akoma është më e ulët nga viti 2007, gjegjësisht nga viti 2006. Besim më të lartë në organizatat qytetare prej 55,1% kanë studentët, e ngjashëm është edhe me të rinjtë e moshës prej 18 deri 29 vjet (50,5%) dhe të punësuarit në sektorin publik (50,5%). Besim më të vogël kanë amviset (34,5%), personat me arsim të kryer të mesëm (34,1%) dhe personat me moshë mbi 65 vjet (36,4%).

Edhe maqedonasit etnik edhe shqiptarët etnik kanë besim të ngjashëm prej 41,3%, gjegjësisht 42,9%, ndërsa i parëndësishëm është dallimi edhe në bazë të përkatësisë religjioze, pasi që edhe të krishterët (41,2%) dhe myslimanët (44,6%) janë me nivel të ngjashëm të besimit në organizatat qytetare. Gjithashtu, nuk ka dallim të mëdha edhe te simpatizuesit e partive politike, edhe pse është vërejtur rënie e matur e besimit nga ana e simpatizuesve të LSDM dhe PDSH. Besim më të madh në organizatat qytetare kanë simpatizuesit e BDI (48,5%), ndërsa më të vogël të LSDM 38,9%.


Tabela II.1. Dallime në besimin në organizatat qytetare mes simpatizuesve të partive politike në vitin 2010 dhe 2008

	VMRO DPMNE	LSDM	BDI	PDSH	Demok. e Re	Nuk. simp.	Gjithsej
2010	42,9 %	38,9 %	48,5 %	43,9 %	39,4 %	43,7 %	42,5 %
2008	40,7 %	44,6 %	41,9 %	34,2 %	56,8 %	39,6 %	41,2 %

Besimi në kishat dhe bashkësitë fetare

Siç u theksua më sipër, në kishat dhe bashkësitë fetare qytetarët kanë besim dukshëm më të madh se sa në aktorët tjerë të shoqërisë civile. Në nivel të institucioneve individuale me besim më të madh nga qytetarët është Kisha Ortodokse Maqedonase (KOM) me 49,9%, pastaj Bashkësia Islame në Maqedoni (BIM) me 41,3%, Kisha Katolike me 22,6% dhe bashkësitë tjera fetare me më pak se 20%.

Grafiku II.2. Besimi në kishat dhe bashkësitë fetare



Për shënim është edhe e dhëna se të rinjtë e moshës 18 deri 29 vjet kanë besim më të madh (68,3%). Më afër tyre është besimi nga ana e më të rriturve (mbi 65 vjet) që është 67,9%. Besimi i më të rinjve dhe më të rriturve është për dhjetë pikë përqindësh më shumë nga grupet tjera të moshës. Besimi në kishat dhe bashkësitë fetare ka lidhje edhe me statusin social dhe i njëjti është proporcionalisht i kundërt. Në të vërtetë, të anketuarit të


cilët kanë deklaruar se i takojnë klasës më të lartë kanë më pak besim (51,9%), dhe i njëjti rritet me zvogëlimin e statusit. Më së shumti besim kanë pjesëtarët e klasës më të ulët (69,2%). Proporcionalisht i kundërt është trendi edhe në raport me të ardhurat mujore edhe në raport me nivelin e arsimit të anketuarve.

